



**Republika e Kosovës**

**Komuna e Drenasit**

**Kuvendi i Komunës**



Nr. 12.060-21314 dt. 22.06.2020

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Labinot Halilaj, më datë: 29/06/2020 (e Hënë) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

**THËRRET  
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS**

Mbledhja do të ketë këtë:

**Rend dite:**

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 27.05.2020.\
2. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KB „Feronikeli”.
3. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KF „Drenasi”.
4. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KV „Feronikeli”.
5. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KH „Drenica”.(M).
6. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KF „Feronikeli”.
7. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për SHKA „Shote Galica”.
8. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për OJQ „Shqipet e Drenicës”.
9. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për projektin e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL)-Drenas .
10. Njoftim rreth përfundimit të kontratës së shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës së Drenasit.
11. Propozim Vendim për miratimin e planit zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028.
12. Draft - Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2021-2023.
13. Propozim Vendim për bashkimin dhe ndarjen e parcelave kadastrave.
14. Propozim Vendim për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e dy fushave sportive, në pronën komunale, në parcelën 2048/0 e cila është në zonën kadastrale në Abri e Epërme dhe parcelën 235/0 e cila është në zonën kadastrale në Zabel të Epërm.
15. Të ndryshme.

Drenas, 22.06.2020

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës  
Labinot Halilaj



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr 12-060/04-19013 dt. 03.06 2020

**Mbledhja e rregullt  
Kuvendi Komunal  
27.05.2020**

### PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të mbajtur më datë: **27.05.2020**

**Mbledhjen e kryesoi: LABINOT HALILAJ – Kryesues**

**Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 30 anëtarë.**

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. **30.04.2020**.
2. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të ngastrave kadastrave, në të cilat ndodhen burimi i ujit të pijes dhe rezervari i ujit ku ndodhet edhe objekti në të cilin janë të vendosura edhe pompat.
3. Raportimi i Kryetarit për pjesën e mjeteve financiare të shpenzuara për menaxhimin e situatës nga COVID -19.
4. Propozim Vendim për rritjen dhe bartjen të hyrave vetanake nga viti 2019 në vitin 2020,me ndryshime.
5. Propozim vendim për miratimin e Statutit të ri të QKMF-së Drenas me ndryshime
6. Draft-Propozim për ndryshim-plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngastra dhe Gjoha 2020,me ndryshime.
7. Të ndryshme.

*Prezent gjatë mbledhjes së rregullt të datës 27 /05/ 2020 ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj, drejtorët e Drejtorive përkatëse dhe përfaqësuesit e Kforit.*

**Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj:** deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së Kuvendit pasi përshëndeti të pranishmit, kryetarit të Komunës **Ramiz Lladrovci**.

**Kryetarit i Komunës Ramiz Lladrovci** –pasi përshëndet të gjithë të pranishmit,propozon dy pikat shtesë për rendin e ditës dhe sqaron për dy pikat e rendit të ditës që janë kthyer ligjshmëritë negative nga MAPL

Propozim vendim për miratimin e Statutit të ri të QKMF-së Drenas me ndryshime.

Draft-Propozim për ndryshim-plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngastra dhe Gjoha 2020,me ndryshime.

**Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj** -Faleminderit kryetar hedh në votim rendin e ditës me dy pikat shtesë

*Për votuan 28 anëtar*

*Kundër s'ka*

*Abstenim s'ka.*

**Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj** Kalojmë tek pika e parë; **1.** Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. **30.04.2020.**

Diskutime nuk pati hedh ne votim këtë pikë të rendit të ditës.

Në mënyrë unanime kalon kjo pikë e rendit të ditës .

**Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj**-hedh ne votim piken e dytë të rendit të ditës.

2 Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të ngastrave kadastrave, në të cilat ndodhen burimi i ujit të pijes dhe rezervari i ujit ku ndodhet edhe objekti në të cilin janë të vendosura edhe pompat

**Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë Ruzhdi Lestrani** -

Propozimi për shpalljen e këtyre parcelave në interes të përgjithshëm publik është bërë me qëllim të realizimit të interesit publik të Komunës së Drenasit për projektin e funksionalizimit të sistemit të ujësjellësit, për të furnizuar banorët e Komunës së Drenasit me ujë të pijes, konkretisht për banorët e fshatit Krojkovë.

Shpronësimit e këtyre pronave janë të domosdoshme për qytetarët e Komunës së Drenasit, që të furnizohen me uji të pijes.

Ky burim i ujit është në prona private, dhe vetëm një pjesë është pronë shoqërore KK. Drenas, prandaj për qasjen në këtë burim të ujit, medoemos duhet të shpallën në interes të përgjithshëm-publik edhe dy parcelat me nr.207/2 me sipërfaqe prej S=737 m2 dhe parcela

nr.208/4 me sipërfaqe prej S=464 m<sup>2</sup>, të cilat janë rrugë private, ku për mesë të këtyre rrugëve shkohet deri në vendin e burimit të ujit, aty ku janë pompat e ujit edhe rezervuari, të cilat janë në parcelën nr.211/4 me sipërfaqe prej S=150 m<sup>2</sup>

Ekipi profesional i Drejtoratit për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë ka dal në vend shqim dhe janë përcaktuar për incizimin e pjesës së ngastrave kadastrale të shënuar më lartë të cilat do të shpronësohen, për të cilat pjesë edhe janë nxjerrë edhe skicat grafike dhe certifikatat mbi të drejtat e pronës.

Pas miratimit të këtij Propozim-Vendim Komuna- kryetari i komunës inicicion procedurën e shpronësimit të pronës - paluajtshmerisë së shënuar më lartë në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Të bashkangjitur e keni skicën e trenit dhe certifikatën e njësisë kadastrale.

**Petrit Gashi** –Ne për këtë propozim vendim vetëm sipërfaqësisht i morëm disa informacione nga arsyetimi i drejtorit sa i përket shpronësimit në komunën e Drenasit kemi pasur shumë probleme edhe me tjera prona dhe kërkojmë një pasqyrë që të kemi të qartë që jepet në kompensim të pronarit, në mënyrë që ne ta dimë për çka po votojmë dhe se cila është në interes të qytetarit gjithashtu edhe në interes tonin publik ta dimë se sa përfiton pronari sa përfiton komuna ?

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci**- Nuk i di marrëveshjet që kanë qenë për shpronësimin në atë kohë në Krajkovë gjatë viteve 70-80 , për arsye që mungojnë shumë dokumentacione ose i kemi të përgjysmuara. Qëllimi i komunës është shpronësimi i kësaj prone një herë e mirë që po e kërkojmë një interes të përgjithshëm. Pronari fiton atë që vendosë komisioni për vlerësimin e pronave në kuadër të ministrisë së financave në nivel të qeverisë, nuk vendosim ne , nuk bëjmë negociata e as marrëveshje për punësime sepse nuk e kemi atë të drejtë. Ne e votojmë ne rast se ju e votoni kjo është në interes për të gjithë qytetarët e Krejkovës të cilët kanë mungesë të ujit të në atë pjesë. Gjatë viteve 1999-2000 janë bërë investime nga komuna ndërsa ne nuk mundemi ta shfrytëzojmë ujin. Uji është aset shtetëror nuk është aset i askujt që kalon nëpër pronë të tij, sidoqoftë ne po kërkojmë shpronësimin miratimin e juaj për atë pjesë.

**Petrit Gashi**- Në fakte un nuk kërkoja vitet 70-80 çfarë marrëveshje ka pas , por në vitin 2015 ka qenë një marrëveshje gjashtëmbëdhjetë vjet pas luftës a ika pasur vetëm komuna e Drenasit ato marrëveshje apo edhe ujësjellësi? Kjo është pronë private , prona private është pronë e shenjtë të gjithë e dimë që uji është interes publik por të paktën duhet të kemi një marrëveshje me e dit edhe qëndrimin e pronarëve, ne nuk e dimë as sa pronar janë, as kush janë e dimë vetëm parcelën që duhet te shpallim ne interes publik faleminderit

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-** Prona private ne demokraci është e shenjtë. Interesi publik i kalon ato, uji është interes shtetëror , edhe uji i puseve që e shfrytëzojmë me ligj është i paraparë të paguhet, ne nuk po e kërkojmë këtë . Pronari ka kërkuar dy vetë me ja punësua edhe ujin me shfrytëzua mos të shpronësohet prona, mirëpo kjo për neve si Komunë është e kundërligjshme.

**Vehbi Berisha-** Në parim gjithçka është në rregull me këtë propozim vendim , për pronën e cila është në interes të komunës. Këtu pas luftës është nisur keq për arsye se disa organizata kanë bërë disa investime në këtë vend burim që vetëm me dërgimin e disa pompave aty përfundon gjithçka, por në fakt nuk është ashtu, dhe pikërisht për këtë çështje e dëgjova drejtorin me kureshtje se çka do të ketë pas shpronësimit sepse sipas informatave që kam nga kjo fushë ku bëjmë edhe analizat e ujitë , aj burim i ujitë ka një sasi të madhe të gëlqeres dhe ndikon në bërjen e gurëve në idhëz ku kanë vuajtur disa banor nga ajo zonë. Pyetja ime është a do të jetë ky vend burim si pjesë e kësaj kompanie pasi që të shpronësohet, për shkak që ne e dim që instituti kombëtar i shëndetit publik vazhdimisht i kontrollon të gjithë ujin.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-** Ne pronën e shpronësojmë dhe prona është komunale. Prona komunale asetin e ujit ja kalon kompanisë sikurse ja kalon shumë investime qoftë kompanisë së ujës-jellësit qoftë kompanisë të pastrimit komuna e ka për obligim me investua. Ne po kërkojmë votën e juaj për interes të përgjithshëm publik. Dhe kërkesa e fshatareve neve na ka bërë me kërkim me shpronësu këtë pronë.

**Nexhmedin Balaj -** nëse ka marrëveshje të vitit 2015 a i ka skadu afati nëse kemi marrëveshje që është valide atëherë ne duhet me pas këtë material sepse i bien si tradhti ndaj pronarit me të cilin keni arrit marrëveshje deshëm e s' deshëm , e dëmshme e pa dëmshëm ka qenë marrëveshje.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-**unë nuk kam gjet marrëveshje mes komunës dhe pronarit të gjithë e dini se uji është aset shtetëror prandaj po kërkojmë miratimin e juaj që ta dërgojmë në shpronësim dhe interes të përgjithshëm publik, pastaj vendoset pagesa në bazë të çmimit të zonës pastaj nëse nuk pajtohen shkon përmes gjykatës ,gjykata është niveli i fundit që e vendos këtë punë.

**Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë Ruzhdi Lestrani-**marrëveshja ska mund të realizohet për arsye këto marrëveshje që janë bërë atëherë ligji i ri nuk i lejon kurse ligji paraprak që ka qenë i ka leju këto marrëveshje që i kanë bërë.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-** Një sqarim,unë e kam një dokument në dorë , kam edhe disa dokumente tjera, një dokument valid që i kanë jap Podrimqakut me 19.02.2002 . Komuna nuk i ka zhvilluar proceduar ashtu si që nuk i ka zhvilluar edhe shumë procedura tjera ne vazhdimësi , e ne po mundohemi që të mos i bëjmë gabimet e njëjta si në të kaluarën. Pronari

edhe në vitin 2002 ka kërkuar që ti kompensohet shpronësimi. Unë flasë zyrtarisht me dokumente Petrit.

**Sabrie Kukaj-** A doni të filloni edhe me shpronësime të burimeve të tjera siqë është aj i Verbocit dhe të merret në menaxhim nga kompania e ujësjesit?

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-** Është një proces tjetër faza e parë ka përfunduar është grandë ose kredi e qeverisë Hungareze tani vinë faza tjera që zgjasin tri deri katër vjet deri në përfundim, sigurisht ne e kemi kaluar fazën tonë janë në nivel të qeverisë, qeveria vazhdon me procedura tjera ne i ndjekim ato procedura.

**Beqir Kiqina-** Prej vitit 2002 që po flitet që ekziston marrëveshja, PDK ku z.Syla ka qenë kryetarë në arkivat e komunës ku është një marrëveshje e tillë, kryetari a ka hulumtuar për këtë apo vetëm po thotë se nuk e kemi një marrëveshje, faleminderit.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-** Fshatarët e Krajkovës kanë pasur marrëveshje me pronarin e pronës që ta paguajnë një punëtor ku çdo familje që ka shfrytëzuar ujin ka pasur të jep nga 1 € në muaj, kjo është përgjigjja e asaj marrëveshje.

**Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj-** Hedhim në votim piken e 2 të rendit të ditës .

*Për votuan 22 anëtar*

*Kundër s'ka*

*Abstenim 5.*

**Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj-** Pika e tretë e rendit të ditës është **Raportimi i Kryetarit për pjesën e mjeteve financiare të shpenzuara për menaxhimin e situatës nga COVID -19.**

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-**së pari kërkoj falje që ne këtë dokument nuk janë fut edhe donacionet që janë dhënë për sektorin e shëndetësisë për komunën për zjarrefiksat për policinë e Kosovës pra shumë donator OJQ kanë dhanë pajisje mbrojtëse siç janë maskat,dorezat,dezinfektues të shumtë, që nuk janë në raport ,në raport nuk janë fut edhe çisa Donacione p.sh në Llapushnik 8 fshatar i kanë dhënë 12 pako,pavarësisht që janë konsultu me mua dhe shumë donacione të tjera që nuk kanë kaluar përmes nesh. Të nderuar asamblist duke dëshiruar që kjo pandemi të kalo sa më shpejt me lejoni që para jush të shpalosim raportin e punës nga data 13.03.2020,respektivisht nga shpallja e emergjencës të shëndeti publik në republikën e Kosovës .Komuna e Drenasit që nga ky moment ka përcjell me vëmendje të gjitha vendimet që kanë dalur nga qeveria duke i postuar në ueb faqe të komunës së Drenasit dhe në të njëjtën kohë duke bërë thirrje që këto vendime të respektohen në përpikëri me datën 12.03.2020 është

formuar shtabi emergjent lokal me numër të vendimit pastaj Drejtoria e Shëndetësisë ka nxjerr vendim me datë 16.03.2020 për prioritet e QKMF-së Drenas ,po ashtu inspektorati komunal vazhdimisht i ka mbikëqyr zbatimin e këtyre vendimeve të krijuara në këtë periudhë të pandemisë me gjithsej 55 vendime pa përfshire vendit tjera administrative, këto vendime mund ti vërtetoni edhe përmes intranetit. Komuna e Drenasit ka krijuar shtabin emergjent një ditë para se të shpallet .Asambleja komunale me datë 25.03.2020 ka marrë vendim për ndarjen e shumës prej 229.200 € sa për informim e juaj Komuna e Drenasit edhe gjatë kohës së pandemisë ka mbajtur mbledhje duke respektuar në përpikëri rekomandimet e dhëna nga IKSHP-S janë mbajtur gjithsej 28 mbledhje, stafi emergjent ka mbajtur 10 mbledhje dhe qendresë operative , bordi i drejtorëve 12 mbledhje, Kuvendi i komunës 3 mbledhje dhe 2 mbledhje të KKSBS ajo që është me rëndësishmja komuna e Drenasit është kujdesur që të menaxhojë shpërndarjen e donacioneve të ndryshme për këtë është krijuar një mënyrë komunikimi drejtëpërdrejt me administratorët e fashtrave me qëllim të identifikimit të nevojtarëve real .Prej fondit 229.200 € janë shpenzuar 85.000€, procedurat janë monitoruar nga koleget e luaj asamblist znj. Florentina Elezi, zoti. Petrit Sinani , zoti. Beqir Kiqina ka mundur për arsyt e tij për këtë qëllim në kemi formuar komisionit që është kujdesur për shpërndarjen e ndihmave dhe zoti. Sokol Bylykbashi ka marrë pjesë po thuajse në të gjitha aksionet kur janë shpërndarë këto donacione dhe çdo qytetar që ka marrë pako , e ka emrin mbiemrin numrin e letërnjoftimit dhe është i evidentuar . Bashkëpunime me administratorët ka qenë shumë i mirë dhe ka qenë transparent dhe është mbikëqyr edhe nga asambleistat po ashtu edhe me kryeqin e kuq kemi pasur një bashkëpunim të mirë dega në Drenas

Beqir Kiqina kisha dashur të ju kërkoj falje publike edhe pse e kam konfirmuar pjesëmarrjen nuk kam mundur me marrë pjesë për arsye shëndetësore, dhe kisha dashur të falënderoj edhe komunën e Drenasit dhe administratorët e fashtrave sepse të gjitha ndihmat kanë shkuar në adresë të duhur dhe kam një pyetje për kryetarin a ka ndonjë plan që pas pandemisë familjet që nuk kanë pasur të ardhura gjatë kësaj periudhe të ndihmohen edhe pas kësaj.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci**-për këto familje ka ndarë pako qeveria e në dorëheqje të cilat nuk besoi që mundet me i realizu sepse duhet miratimi i kuvendit të Kosovës, por shpresoi që qeveria e re do të miratoi këtë pako dhe të ju del në ndihmë këtyre familjeve sepse në si Komunë nuk kemi as buxhet as mundësi .

**Adem Bucolli**-desha me ju falënderuar për menaxhimin e mirë të pandemisë gjatë këtyre muajve keni qenë shembull dhe të gjithë akterët që kanë qenë të ekspozuar direkt me pacëmin.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci**-unë ju falënderoi të gjithëve sepse bashkëpunimi ka qenë pozitiv opozitë por nëse aty këtu ka ndodhe ndonjë gabim ju kërkoj falje

**Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj**-hedh në votim pikën e katër të rendit të ditës

4 .Propozim Vendim për rritjen dhe bartjen të hyrave vetanake nga viti 2019 në vitin 2020,me ndryshime.

**Shyqiri Bublaku** – Shfrytëzoj rastin të i falënderojë të gjithë pjesëmarrësit për përkrahjen morale. Sa i përket raportit ka ndodh një gabim teknik për shumën e përgjithshme prej 0,08 cent dhe në ministrin e financave kanë kërku që në këtë gabim ta përmisojmë për atë edhe e kemi sjellë në kuvendë, dhe kërkoj nga ju mirëkuptim që ta kalojmë dhe te na lejohet shuma për bartjen e mjeteve që është një shumë bukur e mirë që do të na duhet për përudhen që jemi tash të kalojmë pandeminë.

**Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj-** Kërkoj nga ju që te votoni për ndryshimin, kjo pik e rendit të ditës u votua në mënyrë unanime .

**Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj-** Kalojmë tek pika e 5 Propozim vendim për miratimin e Statutit të ri të QKMF-së Drenas me ndryshime.

**Drejtori i Shëndetësisë Dr.Arsim Haxhiu:** Propozim vendimi për miratimin e Statutit të ri të QKMF-së i dërguar për vlerësim në MAPL i aprovuar në kuvendin komunal të Drenasit bazuar në statutin unik të hartuar nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me gjendjen e mjeksisë familjare në Kosovë hartuar nga Ministri, kërkohet që të bëhet një plotësim ndryshim në këtë statut. Në nenin 6 të statutit të QKMF-së në Drenas paragrafi 6.9 ku shkruan specialist i radiologjisë në kabinetin e radiologjisë të hiqet në tërësi dhe të vazhdoj në paragrafin pasues. Ndryshimi tjetër neni 9 paragrafi 1.1.7 të largohet radiologu të mbetet vetëm kabineti i radiologjisë. Plotësim ndryshimi behët me arsyeshmeri, sepse të gjitha statutet të komunave të Kosovës në fushën e shëndetësisë dhe të jenë unike dhe në përputhje në politikat nacionale . Ju ftoj të kalojmë këtë pikë.

**Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj-** Kërkoj nga ju që te votoni për ndryshimin, kjo pik e rendit të ditës u votua në mënyrë unanime .

**Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj-** Kalojmë tek pika e 6 Draft-Propozim për ndryshim-plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngastra dhe Gjoha 2020,me ndryshime.

**Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë Ruzhdi Lestrani -** Ministria e Shëndetësisë ka kërkuar sipas udhëzimeve administrative konkretisht sipas udhëzimit administrativ 04.2007 në të cilin është kërkuar që të vendoset komplet qmimorja , dhe ka kërkuar që të vendoset qmimorja me nr 1 shkresa 1 qmimorja për certifikata shëndetësore sipas udhëzimit administrativ të shëndetësisë 04.2015 dhe kjo të vendoset në tërësi siq është në udhëzim edhe pse QKMF në Drenas nuk i ofron të gjitha këto shërbime, këto janë kërkesat e Ministrisë së Shëndetësisë.

**Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj-** Kërkoj nga ju që te votoni.

*Për votuan 27 anëtar*

*Kundër s'ka*

*Abstenim 2.*

**Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj-** Kalojmë tek pika e 7 Të ndryshme.

**Beqir Kiqina-** Kisha dashtë disa kërkesa për lagjen Vrellaku në Baicë të i parashtroj këtu, është një lagje e cila nuk e ka ndi dorën e komunës nga përfundimi i luftës do të thot nuk ka rrugë , kanalizim, ujësjellës po ashtu problem tjetër kanë edhe me emërimin e rrugëve në të cilën janë vendosur edhe emra pa dëshirën e banorëve, kërkoj nga komisioni për emërim dhe riemërimin të rrugëve që të jen më efikas në këtë punë dhe ti kenë parasysh kërkesat e banorëve.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-** Unë kam komunikuar me banorët e lagjes Vrellaku dhe e kanë ndi dorën e komunës dhe të shtetit sepse rruga kryesore që kalon nga Drenasi për Baicë Tërredefcë dhe lidhet më komuna tjera. Pra ne do të marrim masa për aq sa na lejohet . I kam jap urdhër Lumes me shku me ndërmarr masa gjithashtu dhe Drejtoria e Infrastrukturës është duke punuar.

**Sabrie Kukaj-** Nëse nuk kam harruar ose e kam gabim , se di a e kemi shpallur pjesën të lumit zonë me interes publik se di deri ku kanë shkuar procedurat ose a mund të fillohet që ajo pjesë të rregullohet se është tmërri i Drenasit ajo pjesë që ka mbetur atu. Krejt 150 metra që sa vite jemi duke e përmendur këtë çështje të këti lumit dhe s'është punë të hiqt ajo ndotje , krejt ujërat e zeza nga Çikëtova e Vjetër derdhen atu dhe kjo pjesa tjetër nuk mundë të rregullohet nëse ajo pjesë nuk mund të rregullohet . Nuk e di deri ku kanë shkuar procedurat dhe a është shpallur ajo zonë me interes publik.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-** Shtrati i lumit është projekt i ministrisë së ambientit dhe planifikimit hapësinor projekt 2milion e 370.000 € i cili ka përfunduar që 7-8 vjet dhe unë me 400-500.000€ 45km shtrat të lumit i kamë rregulluar i kamë pastruar ata 1km nuk kanë mundur me përfundua me projektin e lartpërmendur pra është projekt i tyre që kanë pasur edhe ti vendosin kolektorët për gjatë shtratit të lumit ku shkon deri të Guri i Plakës për të i larguar të gjitha ujërat e zeza. Ne punët teknike i kemi përfunduar.

**Sabrie Kukaj-** Po i tregoj Beqës që është hall i madh të punohet në atë komision dhe nuk mund të plotësohen të gjitha dëshirat dhe kërkesat e qytetarëve për emërim të rrugëve.

**Petrit Gashi-** Si anëtar i komisionit për emërtime të rrugëve dua të i jap vetëm disa informacione në fakt në mungesë të një anëtar i cili nuk i është bashkangjitur komisionit . Takimin e parë e kemi mbajtur në tetor të vitit të kaluar ku kemi vizituar 113 rrugë çdo rrugë është vizituar me kërkesa për 15 ditë me radhë në 15 fshatra ku është bërë një takim për të shqyrtuar këto kërkesa disa që kanë pasur propozim vendim për ndryshim a i plotësojnë kushtet ku i kemi klasifikuar kërkesat që i plotësojnë dhe ato që nuk i plotësojnë kushtet dhe janë diku 315 kërkesa në komunën e Drenasit ku janë ndërprerë për shkak të gjendjes së pandemisë a që ka pasur të përfundoj sipas planit tonë diku me 25 Mars mirëpo është ndërpre dhe ka mbetur edhe pjesa tjetër e disa kërkesa pa përfunduar.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-** Petrit faleminderit , ashtu siç e ceku edhe mësuesja se e keni shumë të vështirë të punoni por duheni të ja shpjegoni qytetarëve se ajo rrugë që vendoset nga kuvendi jo nga dëshira e lagjeve ju e keni obligim të i konsultoni por shumica gjithmonë duhet me vendos . Unë kam propozuar tri rrugë emrin e Adem Demaqit , Adem Vokrrit , Bekim


Pasi nuk pati diskutime tjera vërejtje apo sugjerime, kryesuesi i Kuvendit Komunal konsideroi si të mbyllur mbledhjen.

*Mbledhja përfundoi rreth orës: 11: 45 min.*

Procesmbajtëse:

  
Zahrie Podrimçaku Subashi



  
Kryesuesi i Kuvendit  
Labinot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Drenasit  
Zyra e Kuvendit



**Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me datë 22.06.2020, si vijon:**

Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj. -Pasi kryesuesi përshëndeti të pranishmit njoftoi anëtarët e K. P.F-ca, me rendin e ditës, si dhe rreth pikës 14, i njoftoi se është një ndryshim vetëm të përcaktimi i emrit dhe materiali nuk ndryshon është i njëjti ku ky ndryshim ka ndodh nga ekzekutivi pasi ju kemi dërguar materialin anëtarëve.

Kryesuesi i Kuvendit i ftoi anëtarët ta votonin rendin e ditës:  
Miratua me **07 vota Për, Kundër: 00, dhe abstenim: 00**

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 20.05.2020.  
- **Votuan 07,vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**
2. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KB „Feronikeli”.  
- **Votuan 07,vota Për, Kundër: 0, dhe Abstenim: 0**
3. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KF„Drenasi”.  
**Votuan 07,vota Për, Kundër: 0, dhe Abstenim: 0**
4. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KV„Feronikeli”.  
- **Votuan 07,vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**
5. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KH„Drenica”.(M).  
- **Votuan 07,vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**
6. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KF„Feronikeli”.  
- **Votuan 07,vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**
7. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për SHKA„Shote Galica”.  
- **Votuan 07,vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**
8. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për OJQ„Shqipet e Drenicës”.  
- **Votuan 07,vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**
9. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për projektin e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL)-Drenas .

- **Votuan 07,vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**

10. Njoftim rreth përfundimit të kontratës së shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunes së Drenasit.

- **Edhe kjo pikë e rendit të ditës kaloj për Kuvend**

11. Propozim Vendim për miratimin e planit zhvillimor Komunal të Gillogcit 2020-2028.

- **Votuan 07,vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**

12. Draft - Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2021-2023.

- **Votuan 07,vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**

13. Propozim Vendim për bashkimin dhe ndarjen e parcelave kadastrave.

- **Votuan 05,vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 02**

14. Propozim Vendim për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e dy fushave sportive, në pronën komunale, në parcelën 2048/0 e cila është në zonën kadastrale në Abri e Epërme dhe parcelën 235/0 e cila është në zonën kadastrale në Zabel të Epërme.

- **Votuan 07,vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**

15. Të ndryshme.

Pasi spati diskutime mbledhja përfundoi në ora 11:10.

 Sekretar i Kuvendit  
Labinot Halilaj

 REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E DRENASIT GJILJAN MUNICIPALITY			
Pranimet		16-06	2020
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
	01-400-	20406	

Republika e Kosovës  
 Republika Kosova-Republic of Kosovo  
 Komuna e Drenasit  
 Zyra e Kryetarit



Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nën-paragrafi h të Ligjit Vetëqeverisjes Lokale nr.03/L-040, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 nr.320-19332 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, rregullores MF-NR 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, vendimit me nr12.nr.400-37743 të datës 03.07.2018 Për plotësim ndryshimin e Rregullores nr12-320-19338 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, pastaj Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2020. Me propozim të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryetari i Komunës para Kuvendit paraqet këtë:

### PROPOZIM VENDIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

#### Neni 1.

Me këtë propozim vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin e KB,,Feronikeli". Lidhur me mbulimin e shpenzimeve për sezonin pranveror-vjeshtor 2020, anëtar i Superligës së Kosovës.

#### Neni 2.

Projekti i KB,,Feronikeli", përkrahet me shumën prej **6,200.00€ (gjashtë mijë e dyqind euro)**, mjete të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2020.

#### Neni 3.

Financimi - Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i DRKS-në nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencioneve dhe tranfereve, kodi ekonomik 21/611/85001/21200/0000/0820.

#### Neni 4.

Mjetet financiare barten në konton e KB,,Feronikeli". Drejtorati i Kulturës, Rinisë dhe Sportit është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij propozim vendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga KB,,Feronikeli", që të bëjë raport tekstual dhe financiar në mënyrë që të njoftoj DKRS-në për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

#### Neni 5.

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtorja për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport.

KRYETARI I KOMUNËS

  
 Ramiz Lladrovci





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA GLOGOC			
GLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar		16.06	2020
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-400-	20410		

Komuna e Drenasit  
Zyra e Kryetarit

Në vështrim të nenit 58, paragrafi I, nën-paragrafi h të Ligjit Vetëqeverisjes Lokale nr.03/L-040, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 nr.320-19332 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, rregullores MF-NR 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, vendimit me nr.12.nr.400-37743 të datës 03.07.2018 Për plotësim ndryshimin e Rregullores nr.12-320-19338 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, pastaj Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2020. Me propozim të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryetari i Komunës paraqet këtë:

### PROPOZIM VENDIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

#### Neni 1.

Me këtë propozim vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin e KF „Drenasi”. Lidhur me mbulimin e shpenzimeve për sezonin pranveror-vjeshtor 2020, anëtare e Ligës së Parë të Kosovës.

#### Neni 2.

Projekti i KF „Drenasi”, përkrahet me shumën prej **6,000.00€ (gjashtë mijë euro)**, mjete të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve të klubit për vitin 2020

#### Neni 3.

Financimi-Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i DRKS-së nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencioneve dhe tranferëve, kodi ekonomik 21/611/85001/21200/0000/0820.

#### Neni 4.

Mjetet financiare barten në konton e KF „Drenasi”. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij propozim vendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga KF „Drenasi”, që të bëjë raport tekstual dhe financiar në mënyrë që të njoftoj DKRS-në për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

#### Neni 5.

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

  
KRYETARI I KOMUNËS  
Ramiz Dladrovci

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLOGOC			
GLOGOC MUNICIPI			
16.10.2020			
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vizë
01-	400-	20411	

Republika e Kosovës

Republika e Kosovës - Republic of Kosovo

Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit



Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nën-paragrafi h të Ligjit Vetëqeverisjes Lokale nr.03/L-040, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 nr.320-19332 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, rregullores MF-NR 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, vendimit me nr.12.nr.400-37743 të datës 03.07.2018 Për plotësim ndryshim të Rregullores nr.12-320-19338 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, pastaj Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2020. Me propozim të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryetari i Komunës paraqet këtë:

### PROPOZIM VENDIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

#### Neni 1.

Me këtë propozim vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin e KV „Feronikeli”. Lidhur me mbulimin e shpenzimeve për sezonin pranveror-vjeshtor 2020, anëtar i Superligës së Kosovës.

#### Neni 2.

Projekti i KV „Feronikeli”, përkrahet me shumën prej **2,000.00€ (dy mijë euro)**, mjete të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve të klubit për vitin 2020.

#### Neni 3.

Financimi-Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i DRKS-së nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencioneve dhe tranferëve, kodi ekonomik 21/611/85001/21200/0000/0820.

#### Neni 4.

Mjetet financiare barten në konton e KV „Feronikeli”. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij propozim vendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga KV „Feronikeli”, që të bëjë raport tekstual dhe financiar në mënyrë që të njoftoj DKRS-në për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

#### Neni 5.

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.



KRYETARI I KOMUNËS

Ramiz Lladrovci

REPUBLIKA E KOSOVES KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar	18.06	2020	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-	400-	20420	



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**Komuna e Drenasit**  
Zyra e Kryetarit



Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nën-paragrafi h të Ligjit Vetëqeverisjes Lokale nr.03/L-040, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 nr.320-19332 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, rregullores MF-NR 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, vendimit me nr12.nr.400-37743 të datës 03.07.2018 Për plotësim ndryshimin e Rregullores nr12-320-19338 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, pastaj Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2020. Me propozim të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryetari i Komunës paraqet këtë:

**PROPOZIM**  
**VENDIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT**

**Neni 1.**

Me këtë propozim vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin e KH „Drenica”(M). Lidhur me mbulimin e shpenzimeve për sezonin pranveror-vjeshtor 2020, anëtare e Superligës së Kosovës.

**Neni 2.**

Projekti i KH„Drenica”, (M) përkrahet me shumën prej **8,000.00€ (tetë mijë euro)**, mjete të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve të klubit për vitin 2020.

**Neni 3.**

Financimi-Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i DRKS-së nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencioneve dhe transfereve , kodit ekonomik 21/611/85001/21200/0000/0820.

**Neni 4.**

Mjetet financiare barten në konton e KH „Drenica” (M). Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2.të këtij propozim vendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga KH „Drenica” (M), që të bëjë raport tekstual dhe financiar në mënyrë që të njoftoj DKRS-në për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

**Neni 5.**

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit dhe vlerësimi të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.



**KRYETARI I KOMUNËS**

**Ramiz Lladrovci**

 REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar		16 06	2020
Nr. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-	400	20409	

Republika e Kosovës  
 Republica Kosova-Republic of Kosovo  
 Komuna e Drenasit  
 Zyra e Kryetarit



Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nën-paragrafi h të Ligjit Vetëqeverisjes Lokale nr.03/L-040, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 nr.320-19332 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, rregullores MF-NR 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, vendimit me nr.12.nr.400-37743 të datës 03.07.2018 Për plotësim ndryshimin e Rregullores nr.12-320-19338 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, pastaj Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2020. Me propozim të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryetari i Komunës para Kuvendit paraqet këtë:

## PROPOZIM VENDIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

### Neni 1.

Me këtë propozim vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin e KF „Feronikeli”. Lidhur me mbulimin e shpenzimeve për sezonin pranveror-vjeshtor 2020, anëtar i Superligës së Kosovës.

### Neni 2.

Projekti i KF „Feronikeli”, përkrahet me shumën prej **40,000.00€ (katërdhjetë mijë euro)**, mjete të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve të klubit për vitin 2020.

### Neni 3.

Financimi-Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i DRKS-së nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencioneve dhe tranferëve, kodë ekonomik 21/611/85001/21200/0000/0820.

### Neni 4.

Mjetet financiare barten në konton e KF „Feronikeli”. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij propozim vendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga KF „Feronikeli”, që të bëjë raport tekstual dhe financiar në mënyrë që të njoftoj DKRS-në për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

### Neni 5.

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

  
**KRYETARI I KOMUNËS**  
  
**Ramiz Lladrovci**

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E DRENASIT REPUBLIC OF KOSOVO DRENAS MUNICIPALITY			
Formel		16.06	2020
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-	400-	20412	

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit



Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nën-paragrafi h të Ligjit Vetëqeverisjes Lokale nr.03/L-040, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 nr.320-19332 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, rregullores MF-NR 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, vendimit me nr.12.nr.400-37743 të datës 03.07.2018 Për plotësim ndryshimin e Rregullores nr.12-320-19338 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, pastaj Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2020. Me propozim të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryetari i Komunës para Kuvendit paraqet këtë:

### PROPOZIM VENDIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

#### Neni 1.

Me këtë propozim vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin SHKA „Shote Galica”. Lidhur me mbulimin e shpenzimeve për zhvillimin e aktivitetit për vitin 2020.

#### Neni 2.

Projekti i SHKA „Shote Galica” përkrahet me shumën prej **2,000.00€ (dy mijë euro)**, mjete të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve të Shoqëris Kulturore Artistike për vitin 2020.

#### Neni 3.

Financimi-Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i DRKS-së nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencioneve dhe transfereve, kodi ekonomik 21/611/85001/200/0000/0820

#### Neni 4.

Mjetet financiare barten në konton e SHKA „Shote Galica”. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij propozim vendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga SHKA „Shote Galica”, që të bëjë raport tekstual dhe financiar në mënyrë që të njoftoj DKRS-në për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

#### Neni 5.

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

KRYETARI I KOMUNËS



Ramiz Lladrovci





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
Data		16.06	2020
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-	400-	20417	

Komuna e Drenasit  
Zyra e Kryetarit

Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nën-paragrafi h të Ligjit Vetëqeverisjes Lokale nr.03/L-040, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 nr.320-19332 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, rregullores MF-NR 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, vendimit me nr.12.nr.400-37743 të datës 03.07.2018 Për plotësim ndryshimin e Rregullores nr.12-320-19338 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, pastaj Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2020. Me propozim të Drejtorisë për Kulturë, Rinë dhe Sport, Kryetari i Komunës para Kuvendit paraqet këtë:

### PROPOZIM VENDIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

#### Neni 1.

Me këtë propozim vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin OJQ „Shqipet e Drenicës”. Lidhur me mbulimin e shpenzimeve për zhvillimin e aktivitetit për vitin 2020.

#### Neni 2.

Projekti i OJQ „Shqipet e Drenicës”, përkrahet me shumën prej **2,500.00€ (dy mijë e pesëqind euro)**, mjete të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve të OJQ-së për vitin 2020.

#### Neni 3.

Financimi-Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i DRKS-së nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencioneve dhe tranferëve, kodi ekonomik 21/611/85001/200/0000/0820

#### Neni 4.

Mjetet financiare barten në konton e OJQ „Shqipet e Drenicës”. Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij propozim vendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga OJQ „Shqipet e Drenicës”, që të bëjë raport tekstual dhe financiar në mënyrë që të njoftoj DKRS-në për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

#### Neni 5.

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport.



KRYETARI I KOMUNËS

Ramiz Lladrovci

Pranuar 16.06 2020

Nj	Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01		400	20423	



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit



Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nën-paragrafi h të Ligjit Vetëqeverisjes Lokale nr.03/L-040, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 nr.320-19332 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, rregullores MF-NR 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, vendimit me nr.12.nr.400-37743 të datës 03.07.2018 Për plotësim ndryshimin e Rregullores nr.12-320-19338 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, pastaj Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2020. Me propozim të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryetari i Komunës para Kuvendit paraqet këtë:

### PROPOZIM VENDIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

#### Neni 1.

Me këtë propozim vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL) – Drenas, lidhur me mbulimin e shpenzimeve për zhvillimin e aktiviteteve për vitin 2020.

#### Neni 2.

Projekti i Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL) – Drenas, përkrahet me shumën prej **3,000.00€ (tre mijë euro)**, mjete të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2020.

#### Neni 3.

Financimi-Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i DRKS-së nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencioneve dhe tranferëve, kodi ekonomik 21/611/85001/200/0000/0820

#### Neni 4.

Mjetet financiare barten në konton e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL)-Drenas. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij propozim vendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga Këshilli i Veprimit Rinor Lokal (KVRL) – Drenas, që të bëjë raport tekstual dhe financiar në mënyrë që të njoftoj DRKS-në për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

#### Neni 5.

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.



KRYETARI I KOMUNËS

Ramiz Eladrovci



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Drenasit  
Zyra e Kryetarit



01 Nr 462/21-20458 dt. 16/06/2020

DATE/A:	16.06.2020
PËR/ZA/TO:	Asambletë e Kuvendit të Komunës së Drenasit
NGA/OD/FROM:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Drenasit;
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim rreth përfundimit të kontratës së shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës së Drenasit!



Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Drenasit,

Duke pasur për bazë Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, respektivisht nenin 23 paragrafin 1 dhe 2, ju njoftoj si në vijim:

Komuna e Drenasit gjatë viteve paraprake ka lidhur disa kontrata për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cilave kontrata ju ka skaduar afati i shfrytëzimit, andaj ashtu siç me obligon legjislacioni në fuqi po ju njoftoj me ato prona:

Kontrata e lidhur me datë 13/05/2010, me nr.465-1036, me sipërfaqe 0.10.00 ha, e cila është pjesë e ngastrës nr.1/8, në Zonën Kadastrale në Komoran.

Shfrytëzues i përkohshëm (10 vite) ka qenë N.SH "EURO-B-LAB" me Sala Shala-Gjoshi nga fshati Sankoc.

Duke mos pasur asnjë mundësi të vazhimit të tyre, sepse një gjë të tillë e ndalon neni 23 paragrafi 1 i Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i cili thotë: Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës, në këtë formë duke mos lejuar asnjë vazhdim të asnjë kontrate, pa marr parasysh investimet e bëra nga personat që e kanë pasur në shfrytëzim pronën e paluajtshme komunale.

Sa për informacionin tuaj, në lidhje me këtë çështje i kemi shkruar edhe Ministrinë së Administrimit të Pushtetit Lokal, ku i kemi kërkuar sqarime se si të veprojmë, e njëjta është përgjigjur se të gjitha pronat e dhëna në shfrytëzim pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratë i kthehen komunës.

Andaj, prona e lartcekura, edhe në bazë të listës së veçantë, ashtu siç e parasheh neni 13 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nuk është paraparë që të ipet në shfrytëzim për këtë vit, po ashtu kjo parcelë do të vlerësohet nga ana e Komunës së Drenasit, se e njëjta a do të ipet në shfrytëzim apo do të shfrytëzohet për interesat e Komunës së Drenasit, gjithnjë në përputhje me planin zhvillimor ekonomik të Komunës sonë.

- Bashkangjitur gjeni kërkesën nga Komuna e Drenasit, si dhe përgjigjen e MAPL-së Nr.463-32, të datës 10.01.2020.

R.21

From: Flamur Curri  
Sent: 11 December 2019 10:10  
To: Besim Murtezani; Xhevat Tafa  
Cc: Ramiz Lladrovci; Rozafa Ukimeraj; Nazmi Hasi  
Subject: Kërkesë nga Komuna e Drenasit!

Të nderuar,

Po ju shkruaj në lidhje me Ligjin Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunale, i cili ka hyrë në fuqi në Mars të vitit 2019, e gjithë kjo duke pasur parasysh që çdo veprim nga ana e Institucioneve Lokale do të këtë për bazë vlerësimin e ligjshmërisë nga ana juaj, respektivisht MAPL-së, në lidhje me këtë çështje.

Komuna e Drenasit, nder vite ka dhëne në shfrytëzim disa prona të paluajtshme, disa prej të cilave në shfrytëzim afatshkurtër e disa në shfrytëzim afatgjatë.

Kohet e fundit kemi shumë kërkesa për vazhdimin e kontratave nga ana e shfrytëzuesve të pronave të paluajtshme, të cilat i kanë pasur në shfrytëzim afatshkurtër, e të cilëve ju ka skaduar afati i shfrytëzimit, gjithnjë të njëjtit duke u bazuar në kontratat e nënshkruara me Zyrtarin Kryesor Administrativ, në të cilat kontrata është lenë edhe mundësia e vazhdimit të tyre. Problemi shfaqet kur kemi parasysh paragrafin 1 të nenit 23 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunale, i cili thotë: Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës.

Me mirëkuptim kërkojmë nga ana juaj, nëse është e mundshme ndonjë mundësi e vazhdimit të atyre kontratave, (gjithnjë duke u vazhduar prona e dhëne në shfrytëzim përmes Kuvendit) të cilat jo vetëm i kanë përmbushur obligimet kontraktuale por edhe të njëjtit i kanë tejkaluar, p.sh. kemi biznese të cilat e kanë dyfishuar apo trefishuar investimin për të cilin janë zotuar, si dhe e kanë trefishuar numrin e punëtoreve.

Andaj, nëse do të kishim ndonjë alternativ nga ana juaj, duke u bazuar në praktikat e ndryshme, do të ishte e mirëseardhur nga ana jonë, në të kundërtën do të ndodhemi në situata tepër të pa lakmueshme, duke dëmtuar jashtëzakonisht shumë biznese, të cilët e kanë në shfrytëzim afatshkurtër Pronën Komunale në Komunën e Drenasit, e të cilët kanë bërë investime të mëdha.

Parapakisht ju falënderoj për gatishmërinë dhe bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,  
Flamur Curri  
Shef i Kabinetit të Kryetarit  
Komuna e Drenasit  
Tel; 03820040582  
Mob; +38349977877  
Emali; [flamur.curri@rks-gov.net](mailto:flamur.curri@rks-gov.net)



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datë: 27.12.2019

Për: Flamur Curri, Shef i Kabinetit të Kryetarit, Komuna e Glllogocit

Lënda: Përgjigje në kërkesë

I nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar një kërkesë nga ju, lidhur me vazhdimin e kontratave nga ana e shfrytëzuesve të pronave të paluajtshme të cilat i kanë pasur në shfrytëzim afatshkurtër.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregulloren Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive shtojca XII, duke u bazuar në vlerësimin e ligjshmërisë sqaron se:

- MAPL, sqaron se Ligji Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunale se pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës;
- Kryetari i Komunës, obligohet që ta njoftoj Kuvendin e Komunës pas përfundimit të kontratë të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, duke përshkruar gjendjen aktuale të pronës, si dhe të jap propozimet për destinimin e saj në të ardhmen.

MAPL, është e gatshme të ofrojë përkrahje dhe ndihmën e nevojshme, për zbatimin e plotë të obligimeve që dalin nga legjislacioni i zbatueshëm për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës.

Me respekt,

**Adrijana Hodžić,**  
Ministre e MAPL-së

Kopje: *Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit*  
*Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit*  
*Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së*  
*Arkivit të MAPL-së*



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**Komuna Glllogoc**  
Zyra e Kryetarit



01-Nr. 400/01-20472 dt. 16/06/2020

Në bazë të nenit 58 pika (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, nenit 10 paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Vendimit për dhënien e Pëlqimit për Miratimin e Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028 nga Departamenti për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, të inicuar dhe hartuar nga Komuna e Glllogocit. Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës, të miratoj këtë:

**PROPOZIM VENDIM**  
**PËR MIRATIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË GLLOGOCIT 2020-2028**

**Neni 1**

Kuvendi i Komunës së Glllogocit të miratoj propozim vendimin për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit për periudhën 2020-2028.

**Neni 2**

Pjesë përbërese e këtij propozim vendimi është Plani Zhvillimor Komunal i Glllogocit për periudhën 2020-2028.

**Neni 3**

Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028 është bërë nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit në konsulencë me GIZ-in (Shoqëria Gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar), Plan A Consulting, sipas procedurave të parapara ligjore.

**Neni 4**

Për zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit për periudhën 2020-2028, përgjegjëse është Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Glllogocit.

R. Li

## Neni 5

Dokumenti i planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij propozim vendimi duhet të jetë në gjuhë zyrtare dhe së paku në 3 (kopje) të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale.

## Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Glllogocit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së dhe pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

  
Kryetari i Komunës  
Ramiz Madrovci

## ARSYETIM

Bazuar në obligimet ligjore që përcaktohen në Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Komuna e Glllogocit ka filluar me procesin e hartimit të Planit Zhvillimor të Komunës.

Procesi i hartimit të PZHK-së ka filluar me vendimin për hartimin e PZHK-së marrë nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit me datë 31.01.2018, në të cilën bartës i procesit të hartimit të PZHK-së është përcaktuar Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Për të udhëhequr procesin e planifikimit në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse, komuna ka themeluar dy mekanizma:

- Ekipin Komunal për Planifikim (EKP) - të përbërë nga të gjitha drejtoritë e komunës së Glllogocit (Drenasit). Ekipi Komunal i Planifikimit ka shërbyer si platformë për të mbledhë informata nga të gjitha drejtoritë dhe kompanitë publike në komunë, si dhe për të dhënë kontribut në përmbajtjen e PZHK-së në të gjitha fazat e hartimit të tij. Për më shumë EKP ka shërbyer për të harmonizuar kërkesat dhe projektet të të gjithë sektorëve në komunë.
- Ekipin Këshillues të Komunitetit (EKK) – të përbërë nga të gjitha komunitetet në komunën e Glllogocit (Drenasit). Anëtarët e EKK-së janë përfaqësues të shoqërisë civile, të rinjëve, grave, të moshuarve, personave më aftësi të veçanta, bizneseve, komuniteteve fetare dhe kryetarë të bashkësive lokale. EKK ka shërbyer si urë lidhëse në mes të komunës dhe qytetarëve të komunës. Detyrë primare e EKK-së ka qenë komunikimi me qytetarë rreth përmbajtjes së PZHK-së në faza të ndryshme të hartimit.

Procesi i hartimit të PZHK-së ka kaluar në katër faza kryesore siç janë: profili, vlerësimi i gjendjes ekzistuese, koncepti i zhvillimit hapësinor, dhe prioritetet strategjike me planin e veprimit. Të gjitha fazat janë përcjellur me pjesëmarrje aktive të qytetarëve dhe akterëve tjerë relevant dhe me mbajtjen e punëtorive për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2020-2028.

Për të vazhduar me procedura të mëtutjeshme për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal për periudhën kohore 2020-2028, bazuar dhe në nenin 11 paragrafi 1 nënparagrafi 1.12 dhe nenit 20 të Ligjit Nr.04/l-174 për Planifikimin Hapësinor dhe Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.05/2014 për pjesëmarrjen e publikut në Planifikimin Hapësinor, neni 4 paragrafi 3 pika 3.1, neni 7 paragrafi 2 dhe 3, nenit 8, 10, 12, është miratuar vendimi për shpalljen në shqyrtimin publik të Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028.

Pas miratimit të vendimit për shpalljen në shqyrtim publik të Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit për periudhën 2020-2028, Komuna e Glllogocit ka shpallur njoftimin publik në të cilën janë njoftuar qytetaret se do të bëhet hapja zyrtare e shqyrtimit publik dhe prezantimin publik të Projekt- Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028.

Me datë 05 shkurt 2020, Komuna e Glllogocit ka hapur Shqyrtimin Publik për Projekt Planin Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028, shqyrtimi publik ka zgjatur 30 ditë nga dita e hapjes, në mënyrë që të kontribuohet në dhënien e vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve në librin e vërejtjeve apo përmes adresës elektronike: pzhkdrenas@gmail.com, po ashtu duke pasur dhe mundësinë për qasje në versionin digjital të dokumentit të PZHK-së në vegzen elektronike <https://kk.rks-gov.net/glllogoc/>.

Pas përfundimit të afatit ligjor për shqyrtim publik të Projekt Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028, Ekipi Komunal për Planifikim (EKP), Ekipi Këshillues i Komunitetit (EKK), ekspertet e kompanisë hartuese të Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit, ekspertet e GIZ-it gjerman, kanë analizuar të gjitha kërkesat vërejtjet, sugjerimet nga ana e qytetarëve dhe në bazë të arsyeshmërisë dhe mbështetjes ligjore janë inkorporuar në Planin Zhvillimor Komunal të Glllogocit për periudhën 2020-2028. Pas inkorporimit të komenteve, vërejtjeve dhe sugjerimeve lidhur me vlerësimin profesional nga ana e Divizionit të Planifikimit Hapësinor, është dorëzuar Kërkesa për miratimin përfundimtar të Projekt- Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, në të cilën është marr Vendim për dhënien e Pëlqimit për Miratimin e Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028.

Falenderim i veçantë për kontribuesit e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028, Ekipin Komunal për Planifikim, Ekipin Këshillues të Komunitetit, ekspertet e kompanisë hartuese të PZHK-së, ekspertet e GIZ-it gjerman, Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, duke i'u ftuar të gjithëve në miratimin e këtij dokumenti të planifikimit hapësinor, i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

R. L

REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA DRELOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranimer		16-06	2020
Nj. Org.	NUMER	BHTJESA	Vlera
01-	03001-	20195	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**  
KOMUNA DRENAS (GLLOGOC)  
Zyra e Kryetarit



**DRAFT- KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE**  
**2021 - 2023**

**Drenas, qershor 2020**

## PËRMBAJTJA

### I. HYRJE

### II. STRATEGJIA ZHVILLIMORE KOMUNALE - DEKLARATA E PRIORITYETEVE AFATMESME

### III. KORNIZA FISKALE

- 3.1 Korniza makroekonomike komunale
- 3.2 Tendenca e të hyrave komunale dhe parashikimet 2021-2023
- 3.3 Plani Komunal i Bashkëfinancimit Sektorial me Ministrinë e Linjës dhe Financimi i Jashtëm
- 3.4 Politikat e reja
- 3.5 Shpenzimet komunale dhe parashikimet 2021-2023
- 3.6. Analiza Gjimore

### IV. KORNIZA E PERFORMANCËS SË SHPENZIMEVE

### V. INFORMACIONET SIPAS PROGRAMEVE

### I. HYRJE

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB-i), që po prezantohet është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu, KAB-i, siguron mekanizmat e nevojshëm për t'arritur objektivat prioritare, të identifikuara në dokumentet strategjike të komunës, përmes integritetit sa më të mirë në procesin buxhetor.

**Kuadri Ligjor:** Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkorja Buxhetore Komunale 2021/01 të lëshuar nga Ministria e Financave dhe Transfereve (MFT-ja) në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit (LMFPP-it).

Ky dokument është baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e priorityeteve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2021-2023. Janë katër faza të përmblidhura për zhvillimin e KAB-it Komunal dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:



## II. DEKLARATA E PRIORITETEVE AFATMESME 2021-2023 NGA STRATEGJIA ZHILLIMORE KOMUNALE

Komuna e Drenasit gjendet në pjesën qendrore të Kosovës, në një sipërfaqe prej: 275.63 km<sup>2</sup>, apo 2.66 përqind e sipërfaqës së territorit të Kosovës. Është njëra nga komunat e mesme të vendit. Pozita gjeografike që ka i mundëson asaj lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit. Komuna e Drenasit ka gjithsej 42 vend banime. Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, Komuna ka 58,451 banorë të organizuar në 8,816 ekonomi familjare, ndërsa për vitin 2021 vlerësohet të ketë përafërsisht 62,753 banorë.

Mbi 1800 biznese operojnë brenda territorit të Komunës. Bazuar në të dhënat e Zyrës për Regjistrim të Bizneseve në Komunën e Drenasit, afërsisht gjysma e tyre merren me veprimtari tregtare, 42% në sektorin e shërbimeve, afërsisht 4.0% në prodhimtari, pjesa tjetër në transport.

Administrata e Komunës së Drenasit është e organizuar përrreth zyrave qendrore dhe zyrave lokale që ofrojnë shërbime në nivel të komunitetit. Nga të cilat pesë (5) janë të vendosura në fshatra .

Vizioni i mëposhtëm për Komunën i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike ekonomike e sociale në Komunë bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjata strategjike, që ka zhvilluar komuna siç janë: në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH-i) 2021-2023 të Qeverisë së Kosovës dhe prioriteteve në bazë të saj, si dhe Qarkoret Buxhetore Komunale 2021 (I) të lëshuar nga Ministria e Financave të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Për tri vitet e ardhshme, vizioni i Komunës së Drenasit është të jetë qendër e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, me urbanizëm modern dhe shërbime efikase e kualitative, e integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare, si të cilat e kulturës së pasur, sportive dhe jetës sportive, me shërbime financiare të zhvilluara dhe ofrim të një kualiteti të mirë jetësor për qytetarët e saj.

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definuar janë së pari lehtësia e komunikimit si dhe së dyti llogaridhënia. Me qëllim të përmbushjes së këtyre dy atributëve binjake prioritetet strategjike të Komunës në periudhën afatmesme janë grupuar në katër (4) prioritete që do të mundësojnë realizimin e qëllimit të vizionit tonë për Komunën.

Katër nga këto prioritete kanë të bëjnë me realizimin e objektivave jashtë, ndërsa një prej tyre është i brendshëm dhe kontribuon në zhvillimin e shërbimeve më të mira komunale për qytetarët e Komunës së Drenasit:

## **1. FORCIMI I EKONOMISË KOMUNALE ME MUNDËSI PËR TË GJITLË**

Rritja e ekonomisë komunale përmes:

- Përmirësimi të standardeve të arsimit dhe nivelit të arritjes (pajisje shkollore, renovime shkollore dhe permirësim, bursa për studime, laboratore)
- Mbështetjes direkte të sektorit bujqësor dhe blegtorisë

## **2. PËRMIRËSIMI I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SË QYTETARËVE**

Krijimi dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre:

- Asistenca sociale për familjet në nevojë, pa të ardhura/të ardhura të ulëta
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile
- Promovimi i projekteve për rinë dhe kulturë, dhe ofrimi i terreneve të reja sportive

## **3. PËRMIRËSIMI I AMBIENTIT TË KOMUNËS DHE QËNDRUESHMËRIA E TIJ**

Absorbimi i popullatës në rritje në komunë dhe njëkohësisht mbrojtja e ambientit përmes:

- Përmirësimi dhe rigjenerimi të infrastrukturës rrugore (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriqimi publik dhe numerizimi); transportit; dhe kanalizimit
- Përmirësimi të standardeve ambientale
- Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara

Ndërsa prioriteti i fundit strategjik i Komunës ka të bëjë me efikasitetin e brendshëm të qeverisë komunale dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët e saj.

#### 4. KRIJIMI I QEVERISË KOMUNALE QË OFRON SHËRBIME EFIKASE DHE QË U PËRGJIGJET KËRKESAVE TË QYTETARËVE

Përmirësimi i shërbimeve komunale karshi qytetarëve duke u fokusuar në qasjen në të afërt dhe të lehtë të tyre në administratë përmes:

- ◆ Ndërtimit dhe rekonstruimit të zyreve komunale (të gjendjes civile) në pika më të afërta të vendbanimeve, më qëllim të ofrimit të shërbimeve.

Katër fushat prioritare të komunës dhe objektivat e saj për periudhën afatmesme 2021-2023 do të shoqërohet me një miks të hyrash dhe shpenzimesh në të pesë kategoritë kryesore ekonomike të shpenzimeve të cilat do të mund të monitorohen dhe raportohen karshi arritjeve.

### III. KORNIZA FISKALE KOMUNALE

3.1 Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtëpërdrejt politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e Qeverisë Qendrore) mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyren fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën më poshtë. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2021-2023 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Komponentet e politikës makroekonomike siç janë Bruto Produkti Vendor, Konsumi dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2021-2023 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike, nënvizon faktin se do të ketë ecuri pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme, më saktësisht në periudhën 2021 - 2023 parashihet një rritje reale vjetore mesatarisht, viti 2021 prej 6.0% derisa në vitet 2022-2023 prej 3.9% , vlerësime në mesin e institucioneve (MFT, Banka Qendrore e Kosovës, Banka Botërore dhe FMN-ja).

Natyrisht se rritja ekonomike ndryshe përkethehet edhe në krijimin e vendeve të reja të punës dhe zbutjen e papunësisë në Komunë, që në periudhën afatmesme pritet të zbutet, nga niveli i përgjithshëm i papunësisë që llogaritet të jetë i lartë.

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rejdhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale.

Aktualisht financimi komunal përfshinë: 1. Të Hyrat Vetanake dhe 2. Grantet Operative. Komunitet po ashtu janë promues të granteve të donatorëve (me mbulim të plotë apo si pjesë të bashkëfinancimeve) si dhe kanë mundësinë e huamarrjës sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Komuna e Drenasit në periudhën afatmesme buxhetore 2021-2023 nuk planifikon të marrë hua nga institucione financiare për të financuar projektet e saj, siç e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Llogaridhënie.

Tabela 1: Indikatorët ekonomik komunal

Përshkrimi	2020 (viti e 1)	2021 (viti e 2)	2022 (viti e 3)	2023 (vlerësim)
<b>Indikatorët makroekonomik në Kosovë</b>				
Rritja reale e BPV, në mesin e institucioneve	-3.2%	6.0%	3.9%	3.9%
Proj.BPV-së nominale (mil.€) nga MFT-FMN-mesatarja	6,955€	7,518€	7,936€	8,385€
Projk.Inflacionit në mesin e institucioneve	1.6%	1.9%	1.5%	1.8%
<b>Indikatorët ekonomik komunal</b>				
Popullsia e Komunës	62338	62753	63174	63932
Numri i bizneseve aktive	1628	1828	2038	2245
Numri i nxënësve	12194	12194	11898	11898

Burimi i të dhënave: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve- Qeveria e Kosovës, 2021-2023 dhe drejtoratet komunale.


### 3.2. TË HYRAT KOMUNALE DHE PARASHIKIMI AFAT-MESËM 2021-2023

Të hyrat e Komunës së Drenasit nga dy burimet e saj kryesore – grantet qeveritare si dhe të hyrat vetanake komunale kanë shënuar rritje nga viti në vit.

Tabela 2: Buxheti Total i Komunës në vite , shprehur në Euro:

Të hyrat sipas sektorve	Aktuali		Projeksioni	
	2020	2021	2022	2023
Spektori i Administratës	7,351,549	7,169,887	7,539,731	7,962,939
Spektori i Arsimit	7,152,418	6,472,573	7,039,890	7,070,544
Spektori i Shendetësisë	1,986,376	2,084,614	2,939,945	2,956,474
<b>Gjithsej të hyrat:</b>	<b>16,490,343</b>	<b>15,727,074</b>	<b>17,519,566</b>	<b>17,989,957</b>

Në bazë të planifikimit të bërë në vitin 2021, të hyrat buxhetore për Komunën si tërësi do të shënojnë rritje graduale. Rënja e të hyrave buxhetore për vitin 2021 do të jetë mesatarisht 4.63% në krahasim me vitin 2020, sipas projeksionit provues (2022-2023) rritja planifikohet të jetë 7.67%. Sipas të dhënave të prezantuara në tabelën, rënja e të hyrave në vitin 2021, kryesisht bazohet në të dhënat e përgjithshme që planifikohet në nivel të Qeverisë nacionale, siç parashihet me KASH-in 2021-2023. Rënja kryesore është reflektuar në Grantin e Përgjithshëm dhe të Arsimit të Komunës.



Të hyrat vetanake komunale, në anën tjetër, kanë shënuar rritje të lehtë nga viti në vit po ashtu. Kjo rritje kryesisht është koncentruar në të hyrat e vetme tatimore, nga Tatimi në Pronë, ku norma tatimore për vitet 2021-2023 nuk ka rritje në bazë të legjislacionit në fuqi, duke llogaritur gjithçka tjetër njëjtë. Realisht nëse shikojmë planifikimin nga viti 2021 deri në vitin 2023 rritja e të hyrave të planifikuara nga Tatimi në Pronë do të jetë për 11.72%.

#### KALKULIMET E TATIMIT NË PRONË:

- *Vlera e patundshmërisë* – sipas ndarjes së pronave në kategori të zonave
- *Vlera e kalkuluar vjetore*- që duhet të mbliidhet sipas vlerësimit të pronës (nëse supozojmë 100% pagesë sipas normave të përcaktuara me ligj)
- *Norma e pagesës vjetore*- Pagesat për vit, duke përjashtuar pagesat e borxhit, interesin dhe penaltitë, si përqindje e vlerës vjetore të kalkuluar
- *Borxhi i akumuluar dhe pagesa e pritur e borxhit*
- *Ndryshimet e pritura në normën e pagesës vjetore*

#### KALKULIMET E TË HYRAVE TJERA:

- Të gjitha të hyrat tjera vetanake të komunave janë të hyra jo-tatimore (kryesisht taksa dhe ngarkesa tjera)
- Niveli i taksave dhe pagesave tjera vendoset nën principin e mbulueshmërisë së shpenzimeve të komunave për ofrimin e shërbimit të kërkuar
- Parashikimi i këtyre të hyrave duhet të bëhet duke parashikuar volumnin e shërbimeve të ofruara

*Tabela 3: Planifikimi i të hyrave buxhetore komunale sipas burimit të financimit për periudhën 2021-2023, shprehur në Euro*

	Komuna: Drenas (Glllogoc)	Grantet dhe	Grantet dhe	Grantet dhe	Grantet dhe
		THV – 2020 (këtë vit) në Euro	THV – 2021 (vitin e 1) në Euro	THV – 2022 (vitin e 2) në Euro	THV – 2023 (vitin e 3) në Euro
<b>BURIMET E TË HYRAVE</b>					
<b>0</b>	<b>GRANTET</b>	<b>15,099,552</b>	<b>14,336,284</b>	<b>16,113,491</b>	<b>16,547,879</b>
	Granti i Përgjithshëm	6,014,566	5,836,097	6,193,656	6,583,861
	Granti i Arsimit	7,130,716	6,447,573	7,013,890	7,043,544
	Granti i Shëndetësisë	1,954,270	2,052,614	2,905,945	2,920,474
<b>1</b>	<b>Të Hyrat nga Lejet e Operimit</b>	<b>125,000</b>	<b>125,000</b>	<b>130,000</b>	<b>135,000</b>
	Funksionimet e subjekteve ekonomike brenda teritorit të komunës.	125,000	125,000	130,000	135,000
<b>2</b>	<b>Shfrytëzimi i Tokës dhe Lejet e Ndërtimit</b>	<b>85,000</b>	<b>85,000</b>	<b>95,000</b>	<b>98,200</b>
	Lejet për ndërtim dhe konstruktive	85,000	85,000	95,000	98,200
<b>3</b>	<b>Inspektimi i Tokës dhe Aktivitetet Gjeodezike</b>	<b>80,000</b>	<b>80,000</b>	<b>85,000</b>	<b>90,000</b>
	Përgatitja e plan.urban.dhe inspekt.që kanë të bëjë me dimensionet e pronës	30,000	30,000	30,000	30,000
	Aktivitetet në teren që kanë të bëjë me matjen e vendit	50,000	50,000	55,000	60,000
<b>4</b>	<b>Shërbimet e Inspektimit të Shëndetit dhe Sigurisë</b>	<b>20,000</b>	<b>20,000</b>	<b>24,000</b>	<b>24,800</b>
	Inspektimi i objekteve që ofrojnë ushqim dhe akomodim publik	10,000	10,000	12,000	12,400
	Inspektimi i ambientit	4,000	4,000	5,000	5,300
	Inspektimi i ndërtimit,shërbimit të zjarrëfikësve dhe konstruktimit	6,000	6,000	7,000	7,100
<b>5</b>	<b>Shfrytëzimi i Pronës Komunale</b>	<b>99,000</b>	<b>99,000</b>	<b>101,000</b>	<b>104,400</b>
	Baza ditore apo bazat tjera për shfrytëzimin e pronës publike për aktivitetet komerciale apo jo komerciale	99,000	99,000	101,000	104,400
<b>6</b>	<b>Pagesat në lidhje me Automjetet</b>	<b>97,000</b>	<b>97,000</b>	<b>99,000</b>	<b>102,400</b>
	Lejet e automjeteve	3,000	5,000	3,000	3,200
	Parkimi në parkingun publik i pajtur me garazhim apo hapësira tjera	5,000	5,000	5,000	5,200
	Regjistrimi i automjeteve	87,000	87,000	89,000	92,000
<b>7</b>	<b>Certifikatat dhe Dokumentet Zyrtare</b>	<b>80,000</b>	<b>80,000</b>	<b>82,000</b>	<b>84,800</b>

	Dokum.lidhur me statusin shoqëror si dhe të lindjes,vdekj,martesës,shkurorizimit	75,000	75,000	80,000	82,000
	Të tjera	5,000	5,000	2,000	2,800
8	<b>Tatimi në Pronë (objekte &amp; tokë)</b>	<b>554,947</b>	<b>614,578</b>	<b>650,580</b>	<b>686,583</b>
	Pagesat e tatimit në pronë	554,947	614,578	650,580	686,583
9	<b>Të Hyrat tjera</b>	<b>192,843</b>	<b>133,212</b>	<b>79,495</b>	<b>52,895</b>
	Pagesat tjera	192,843	133,212	79,495	52,895
I-A.	<b>Nëntotali I-A , Të Hyrat direkte (tatimore dhe jo tatimore)</b>	<b>1,333,790</b>	<b>1,333,790</b>	<b>1,346,075</b>	<b>1,379,078</b>
	Denimet në komunikacion,të grumbulluara përmes Nivelit Qendror (ShPK)	-	-	-	-
	Gjoha të gjykatave	-	-	-	-
I-B.	<b>Nëntotali I-B , Të Hyrat indirekte (Pjesa që i takon komunave)</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
I	<b>Totali i Administratës Komunale (Direkte dhe Indirekte &amp; IA+IB )</b>	<b>1,333,790</b>	<b>1,333,790</b>	<b>1,346,075</b>	<b>1,379,078</b>
	<b>TË HYRAT NGA ARSIMI</b>	<b>25,000</b>	<b>25,000</b>	<b>26,000</b>	<b>27,000</b>
	Qerdhet	25,000	25,000	26,000	27,000
II	<b>Totali – Arsimi</b>	<b>25,000</b>	<b>25,000</b>	<b>26,000</b>	<b>27,000</b>
	<b>TË HYURAT NGA SHËNDETËSIA</b>	<b>32,000</b>	<b>32,000</b>	<b>34,000</b>	<b>36,000</b>
1	Shëndetësia primare	31,000	31,000	32,000	33,000
2	Të tjera	1,000	1,000	2,000	3,000
III.	<b>Totali - Shëndetësia</b>	<b>32,000</b>	<b>32,000</b>	<b>34,000</b>	<b>36,000</b>
Ko di 21	<b>TOTALI I TË HYRAVE VETANAKE TË KOMUNË S ( I+II+III ):</b>	<b>1,390,790</b>	<b>1,390,790</b>	<b>1,406,075</b>	<b>1,442,078</b>
	<b>TOTALI I TË HYRAVE KOMUNALE</b>	<b>16,490,343</b>	<b>15,727,074</b>	<b>17,519,566</b>	<b>17,989,957</b>

Komuna vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare të cilat edhe në tri vitet e ardhshme (2021-2023) do të përbëjnë afërsisht **91.70%** të buxhetit total të komunës, edhe pse në vitet paraprake pjesëmarrja e granteve në buxhet ka qenë përafërsisht **92%**. Të Hyrat Vetanake mesatarisht planifikohet të marrin pjesë në buxhet me **8.30%**, prej tyre të hyrat tatimore me **46.03%**; ndërsa ato jo tatimore marrin pjesë me **53.97%**. Planifikim i të Hyrave nga Burimet Vetanake, ndër vite vlerësohet të ketë rritje prej **1.83%**.

### 3.2.1. Plani komunal i bashkëfinancimit sektorial me ministritë e linjës dhe donatorët

Vlera totale e projekteve më bashkëfinancimi me Ministritë e Linjës dhe Donatorët tjerë për vitet 2021-2023 është në shumë prej: **3,112,500 Euro**. Nga kjo, vlera investuese për projekte do të ketë rritje prej: **2,408,750 Euro**, mjete këto që do të sigurohen nga palët e treta .

Tabela 4: Plani komunal i bashkëfinancimit të sektorit me ministritë e linjës dhe donatorët.

Emri i projektit	Partneri bashkëfinancues	Gjithsej euro:		Prokurimi nga:	Komente	Optionale	
		Komuna	Bashkëfinancuesi			% përfitues mashkuj	% përfitues femra
Ndërtimi i Stadionit (Faza e dytë)	MKRS	300,000	900,000	Komuna		50.5	49.5
Vendosja e Standardeve Para-Shkollore të cilësisë së lartë duke përforcuar Arsimin-Shkencën dhe Ekonomin-SHPRESË	CARITAS-ZVICERAN	3,750	8,750	CARITAS		50.5	49.5
Ndërtimi i rrugës Llapushnik-Berish	MTI	100,000	300,000	Komuna		50.5	49.5
Ndërtimi i kolektorit për grumbullimin e ujrave të zeza	MMPH	100,000	300,000	Komuna		50.5	49.5
Ndërtimi i rrugës kurrizit të Qyqavicës	MZHR	100,000	500,000	Komuna		50.5	49.5
Rregullimi i rrjetit të ujësjellsit në Komunën e Drenasit	MZHR	50,000	200,000	Komuna		50.5	49.5
Rregullimi dhe rikonstruimi i rrjetit të rrugëve në Komunën e Drenasit	MTI	50,000	200,000	Komuna		50.5	49.5
<b>Total financimi</b>		<b>703,750</b>	<b>2,408,750</b>			<b>50.5</b>	<b>49.5</b>

### 3.2.2. Politikat e reja

Komuna e Drenasit në tri vitet e ardhshme do të bëjë nënjekje në mobilizimin e resurseve komunale me qëllim të adoptimit të politikave të reja që kanë inicuar qeveria nacionale e Republikës së Kosovës, por edhe të atyre të inicuar në nivelin e qeverisë komunale.

Fillimisht, ndonëse ende nuk është pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Qeverisë së Kosovës 2021-2023, sygjerimet e Qeverisë së Kosovës janë që shumica e Grantit të Përgjithshëm të komunave që aktualisht është dhjetë përqind (10.00%) e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë Qendrore, (duke përjashtuar të hyrat nga shërbimet e aseteve, të hyrat tjera të jashtëzakonshme, të hyrat e

dedikuara vetanake dhe të hyrat nga huamarrja) do të reduktohet në vitet e ardhshme. Projektionet e bëra për 2021 dhe 2023 në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Kosovës, nuk reflektojnë ende këtë politikë. Për Komunën e Drenasit kjo do të vazhdojë të jetë një risk që duhet trajtuar në të ardhmen dhe në ndërrim strategjitë që duhet ndjekur me qëllim të mbulimit të asaj difference-negative që do të shkaktohej ulja e nivelit të Grantit të Përgjithshëm, për komunën.

**Së dyti**, në rast se në periudhën afatmesme Qeveria e Kosovës do të ndryshojë formulën shtetërore të ndarjes së Grantit të Arsimit për Komuna, në rrejtje kjo që pretendohet të bëhet në bazë të normës e jo të numrit të nxënësve, atëherë kjo do të ketë ndikim të dukshëm në buxhetin e Komunës, ulje Grantin e Arsimit, duhet parasysh se ky grant përbën pjesën më të madhe të buxhetit komunal. **Komuna nuk ka informatat e nevojshme për të bërë analizën e impaktit të kësaj politike.**

**Së treti**, Komuna ndonëse me informata të limituara do të jetë e ndikuar në aspektin buxhetor edhe me rastin e fillimit të aplikimit të Ligjit për gradim në paga për shërbyesit civil të Kosovës, ndonëse ende nuk është bërë ndonjë analizë në lidhje me ndikimin fiskal apo buxhetin e komunës. Tutje, komuna nuk posedon me informatat e nevojshme për të bërë këtë analizë, të cilën në të ardhmën ndoshta do ta ofronte Ministria e Administratës Publike. Në këtë fazë Komunës i mungojnë të dhënat lidhur me kufirin në paga, në mungesë të akteve nën-ligjore për përcaktimin e koeficienteve.

**Së katërti**, sa i përket politikave të reja ose atyre të paralajmëruara nga niveli qendror, me ndikim në Komunë, është edhe politika që do të zgjedhet nga viti 2021 e tutje, në lidhje me trajtimin e mirëqenies sociale si kompetencë e decentralizuar në komunat e Kosovës. Komuna e Drenasit aktualisht nuk posedon informatat e nevojshme në lidhje me mënyrën e ndarjes buxhetore që do të bëhet për financimin e kësaj fushe, ndryshe nga ajo që është aktualisht, ndonëse ka paralajmërime nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Financave sa i përket këtyre politikave për sigurimin e grantit specifik për këtë fushë.

**Së pesti**, Komuna ka mirëpritur deklaratimet e Qeverisë Qëndrore, që në të ardhmen, sa i përket fleksibilitetit të shpenzimeve në të gjitha kategoritë ekonomike, përveç pagave, të kenë mundësi këtë ta bëjnë edhe nga Granti i Përgjithshëm si shtesë, përveç se nga të Hyrat Vetanake Komunale.

Ndërsa sa i përket të hyrave të tjera të Komunës, apo të hyrave vetanake, sërish qeveria nacionale ka shtyrë drejt politikave të reja që do të orientonin komunën drejt avancimit të tatimeve me potencial të mirë dhe zbehjen eventualisht eleminimit të atyre taksave e ngarkesa komunale që rëndojnë ambientin biznesor komunal, janë jo transparente dhe fer, karshi qytetarëve respektivisht tatimpaguesit komunal.

Tutje, Komuna e Drenasit, është ballafaquar gjatë dy viteve të fundit me rënien e dukshme të të hyrave nga ngarkesa e bizneseve si rezultat i lirimit të bizneseve nga ky obligim që po e bëjnë disa komuna të Kosovës. **Qeveria Komunale në 3 vitet e ardhshme planifikon të analizojë trendin e të hyrave nga kjo fushë**, rrjedhimisht në bazë të analizës të propozojë modifikim të vendimit të Asamblesë Komunale, eventualisht propozim të masave shtesë drejt evitimit të çështjeve të dala drejt administrimit të këtij vendimi të marrë nga Asambleja Komunale.

### **3.3.SHPENZIMET KOMUNALE DHE PARASHIKIMI I TYRE AFAT-MESËM 2021-2023**

Sipas rekomandimeve të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar të komunikuara përmes Qarkores Buxhetore MFT. 2021/01, komunat do të kenë edhe në të ardhmen fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2021, duke përfshirë kategorinë Paga dhe Mëdiqe. Si rezultat Komuna e Drenasit prezanton këtë ndarje të shpenzimeve në mes të kategorive ekonomike të shpenzimeve buxhetore:

**Tabelat e kërkesave fillestare buxhetore (2021-2023) sipas programeve-nënprogrameve dhe kategorive kryesore ekonomike të shpenzimeve, shprehur në Euro -€:**

Tabela 5: Kërkesat fillestare buxhetore për vitin 2021

Programet:	Paga dhe Mëdit.	Mall dhe Shërbime	Shërb.Komunale	Subvencione	Sh.Kapitale	Gjithsej:
D.Administratë	252,091	137,600	1,500	1,000	163,000	555,191
D.Gjeod, Kad.Pr	88,608	5,050			400,000	493,658
D.Buxh.dhe Fin.	110,497	17,400				127,897
D.Bujq.Zhvillim Rur	74,623	10,681		40,000		125,304
D.Arsim	6,786,953	719,044	87,057	80,000	395,000	8,068,054
D.Shëndetësi	1,389,220	380,952	48,000	25,000	275,708	2,118,880
Shërb.Sociale	89,501	16,713	5,951			112,165
D.Urban.Pl.Haps.	53,748	17,417			40,000	111,165
D.Kult,Rini,Sport	75,207	47,949		100,400	245,000	468,556
D.Shërb.Publike	175,851	275,395	90,000	4,000	120,000	665,246
D.Inspeksion	54,004	35,515				89,519
Z.Kryetarit	179,816	43,739		5,000		228,555
Z.Kuvendi	126,044	38,000				164,044
Z.Komunitete	9,068	1,082				10,150
D.Zhvillim Ekono.	56,200	23,750		20,000		99,950
D.Infrastrukturë	71,103	22,976			2,194,661	2,288,740
<b>Gjithsej shpenzimet:</b>	<b>9,592,534</b>	<b>1,793,263</b>	<b>232,508</b>	<b>275,400</b>	<b>3,833,369</b>	<b>15,727,074</b>


Tabela 6: Kërkesat fillestare buxhetore për vitin 2022

Programet:	Paga dhe Mëd.	Mall dhe Shërbime	Shërb.Komunale	Subvencione	Sh.Kapitale	Gjithsej:
D.Administratë	253,351	137,600	1,500	1,000	163,000	556,451
D.Gjeod, Kad.Pr	89,051	5,050			400,000	494,101
D.Buxh.dhe Fin.	111,049	17,400				128,449
D.Bujq.Zhv.Rur	74,996	10,681		40,000		125,677
D.Arsim	6,820,888	719,044	87,057	80,000	395,000	8,101,989
D.Shëndetësia	1,396,166	380,952	48,000	25,000	275,708	2,125,826
Shërb.Sociale	89,948	16,713	5,951			112,612
D.Urban.Pl.Haps.	54,017	17,417			40,000	111,434
D.Kultur,R,Sport	75,583	47,949		100,400	245,000	468,932
D.Shërb.Publike	176,730	275,395	90,000	4,000	120,000	666,125
D.Inspeksion	54,274	35,515				89,789
Z.Kryetarit	180,715	43,739		5,000		229,454
Z.Kuvendi	126,674	38,000				164,674
Z.Komunitete	9,113	1,082				10,195
D.Zhvillim Ekono.	56,481	23,750		20,000		100,231
D.Infrastrukturë	71,459	22,976			3,939,190	4,033,625
<b>Gjithsej shpenzimet:</b>	<b>9,640,497</b>	<b>1,793,263</b>	<b>232,508</b>	<b>275,400</b>	<b>5,577,898</b>	<b>17,519,566</b>

Tabela 7: Kërkesat fillestare buxhetore për vitin 2023

Programet:	Paga dhe Mëd.	Mall dhe Shërbime	Shërb.Komunale	Subvencione	Sh.Kapitale	Gjithsej:
D.Administratë	254,618	137,600	1,500	1,000	163,000	557,718
D.Gjeod. Kad	89,495	5,050			400,000	494,546
D.Buxh.dhe Fin	111,604	17,400				129,004
D.Buj.Zhv.Rur	75,371	10,681		40,000		126,052
D.Arsim	6,854,992	719,044	87,057	80,000	395,000	8,136,093
D.Shëndetësi	1,403,147	380,952	43,000	25,000	279,708	2,136,807
Shërb.Sociale	90,308	16,713	5,951			113,062
D.Urban.Pl.Ha	54,287	17,417			40,000	111,704
D.Kult,R,Sport	75,961	47,949		100,400	245,000	469,310
D.Shërb.Publik	177,614	275,395	90,000	4,000	120,000	667,009
D.Inspeksion	54,545	35,515				90,060
Z.Kryetarit	181,619	43,739		5,000		230,358
Z.Kuvendi	127,307	38,000				165,307
Z.Komunitete	9,159	1,032				10,241
D.Zhvilli Ekon.	56,713	23,750		20,000		100,463
D.Infrastruktur	71,816	22,976			4,357,431	4,452,223
<b>Gjithsej shpenzimet:</b>	<b>9,688,647</b>	<b>1,793,263</b>	<b>232,508</b>	<b>275,400</b>	<b>6,000,139</b>	<b>17,989,957</b>

Tabelat e lartshenuara, paraqesin planifikimin e shpenzimeve sipas karakterit ekonomik dhe funksional për vitet 2021-2023, bazuar në kërkesat fillestare të mbajtësve të buxheteve komunale (drejtoratet dhe zyrët komunale). Vlerësimet e përgjithshme për kategori kryesore ekonomike të shpenzimeve janë si më poshtë:



**3.3.1 Pagat dhe Mëditjet** – Qarkorja buxhetore 2021/01-MFT., përfshinë të gjitha kategoritë e shpenzimeve, e po ashtu Pagat dhe shtesat. Punësimi: Në parim nuk do të ketë rritje të punësimit në sektorin publik, përveç kur ka një vendim të qartë për domosdoshmërinë e punësimeve të reja dhe kur është siguruar buxheti. Pagat dhe shtesat: Programet buxhetore duhet të planifikojnë rritjen vjetore të futurës së pagës në nivel prej 0.5% sipas nenit 22C, pika 1.4 të Ligjit 05/L-063. Kërkesat e programeve buxhetore për paga dhe mëditje të paraqitura në tabelat e lartë shenuara janë fillestare, të cilat në fazat e mëvonshme të planifikimit të buxhetit do të vlerësohen dhe miratohen sipas Qarkores Buxhetore 2021/02-MFT.

**3.3.2 Mërrat dhe Shërbimet**.- do të kenë rritje në financim aty ku shprehet e domosdoshme siç është regjistrimi i popullsisë, zgjedhje komunale si dhe furnizim me barna. Programet buxhetore kërkohet t'i identifikojnë burimet brenda skenarëve bazë të tyre nga ato fusha me performancë jo të mirë, ose që nuk janë në përputhje të mjaftueshme me prioritetet e nivelit të lartë të Qeverisë për përmbushjen e aktiviteteve me prioritet të lartë. Kërkesat fillestare buxhetore për vitet 2021-2023, janë paraqitur nga mbajtësit e buxheteve mesatarisht 10.46% brenda kufirit buxhetor.

**3.3.3 Shpenzimet e Shërbimeve Komunale:** priten të kenë pjesmarrje të njëjtë krahasuar me vitin 2020. Kërkesat fillestare sektorjale për buxhet, mesatarisht paraqiten me një rritje prej 19.03%, porë pasi kërkesat për mallra dhe shërbime paraqiten më të vegjla, atëherë kjo është e lejueshme, pasi të dy kategoritë bëjnë pjesë në shpenzimet operative.

**3.3.4 Subvencionet dhe transferet** : kjo kategori ekonomike e shpenzimeve pritet të rritet mesatarisht për 2% në periudhën afatmesme. Kërkesat fillestar buxhetore të mbajtësve të buxheteve, duke u bazuar në projekte konkrete janë paraqitur me një rritje mesatar prej 2.00%.

**3.3.5 Investimet Kapitale** - përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve të përgjithshme dhe pritet të përfaqësojnë rreth 30.08% të shpenzimeve totale në periudhën afatmesme. Gjatë kësaj periudhe, pritet implementimi i projekteve kapitale bazuar në një listë prioritare që përmban projekte me ndikim të përmirësimit të jetës së qytetarve. Pjesa më e madhe e investimeve kapitale gjatë periudhës së ardhshme afatmesme pritet të jetë nga financimi i buxhetit të rregullt, mirëpo një numër i madh i projekteve në sektorë të ndryshëm planifikohet të bashkëfinancohenë me ministrit e linjës dhe donatorët.

### 3.4 Analiza Gjimore

Komuna nuk ka përgatitur një buxhet të përgjegjshëm gjinor të detajuar, por është përpjekur për të vlerësuar se si shpenzimet kapitale janë ndarë për të adresuar çdo pabarazi gjinore në planifikimin e ardhshëm buxhetor. Ne kemi analizuar numrin e grave dhe burrave, djemve dhe vajzave në kuadër të komunës, si në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 8:**

Kategoria	Shifrat sipas Regjistrimit të Popullsisë 2011	%	Gjithsej popullsia e vlerësuar për vitin 2021 (31 dhjetor 2021)	%
Gra	13,516	23.12	14,434	23
Burra	13,956	23.83	15,061	24
Vajza	15,242	26.01	16,317	26
Djem	15,737	26.99	16,944	27
<b>Popullata e përgjithshme</b>	<b>58,451</b>	<b>100.00</b>	<b>62,756</b>	<b>100.00</b>

